



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1117/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Besir Bytyqi kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Prizren nga radhët e koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), paraqitur kundër komisionarëve të qendrave të votimit, për shkak të mungesave të votave për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Besir Bytyqi kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Prizren nga radhët e koalicionit AAK-LDD.

Arsyetim

PZAP-i , më datën 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Besir Bytyqi kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Prizren nga radhët e koalicionit AAK-LDD, në të cilën thekson se duke u bazuar nga rezultatet e shpallura nga KQZ-ja rreth numrit të votave si kandidat për asamblenë komunale në Prizren ka pasur keqpërdorim të votave në qendrat e votimit 2001a shkolla fillore Motrat Qiriazi, 2002a SH,F Ibrahim Fehmiu; 2003a Sh,F Abdyl Frashëri ; 2005a gjimnazi Gjon Buzuku sh.f Mustafa Bakiu; 2009a sh,f Mati Logoreci; 2042a sh.m.t 11 Marsi ; 2069 sh,f Pjeter Budi; 2014a sh,f Sezai Surroi; 2023a në të gjitha këto vendvotime. Parashtruesi i ankesës ka dyshime se në qendrat e votimit të lartcekura votat u janë keqpërdorur nga të gjithë komisionarët dhe se si dëshmi rreth numërimit jo të mirë ka bashkangjitur edhe formularin nga QV 2005x/01R ku parashtruesi i ankesës sipas procesverbalit i ka 303 vota pasi që në atë vendvotim as partia nuk i ka në total shumën e votave të cekura pasi që vet kandidati nuk e din rezultatit e saktë të votave në këtë vendvotimi. Parashtruesi i ankesës më tutje thekson se sipas procesverbaleve të kopjuara nga KQZ-ja në Prizren edhe pse nuk i kanë të gjitha kopjet e procesverbalet e ku rreth 200 të tilla i kanë, numri i gjithëmbarshtëm i votave të tij si kandidat është rreth 179 e ku sipas rezultateve të shpallura nga KQZ-ja është

170 dhe me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës është një dëshmi e rezultateve jo të sakta nga ana e QNR-së

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana e Besir Bytyqi se i mungojnë votat, PZAP-i ka gjetur se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse pasi që PZAP nga veprimet e ndërmarra gjatë shqyrtimit të materialit zgjedhor nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e parashtruara në ankesë, prandaj mbi këtë bazë ankesa konsiderohet si e pabazë. PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1117/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.